



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e komitetit për politikë dhe financa (KPF), e mbajtur më 15.09.2022, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimi më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, nënkyetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, drejtore të drejtorive, zyrtarë komunal dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shume për pjesëmarrjen, e hapim mbledhjen e 8-të të komitetit për politikë dhe financa.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë nga DKRS për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrik-15 gusht;**
- 3. Shqyrtimi i planit komunale për menaxhimin e mbeturinave 2022-2026;**
- 4. Shqyrtimi i propozim vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2023;**
- 5. Shqyrtimi i programit komunal tre vjeçar për banim 2022-2024;**
- 6. Shqyrtimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës P-71510033-01041-1 zona kadastrale Xërxe;**
- 7. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;**
- 8. Të ndryshme;**

Kryesuesi – Dikush ndonjë propozim rrëth rendit të ditës?... Nëse jo, Atëherë po e vendosim në votim miratimit e rendit të ditës për këtë mbledhje, kush është për?... Atëherë me shumicë votash miratohet rendi i ditës;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – Dikush ndonjë koment rrëth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e parë e rendit të ditës.

2. Informatë nga DKRS për muajin e mërgimtarëve prej 15 korrik-15 gusht;

Afrim Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, drejtore, anëtarë të KPF-së. DKRS ka mbajtur aktivitetet tradicionale, muaji i mërgatës 15 korrik-15 gusht, si bartëse e aktiviteteve për muajin e mërgatës përgjegjëse ka qenë DKRS. Manifestimi ka filluar sipas agjendës e cila ka qenë e përpiluar dhe e hartuar nga kryetari i komunës sonë, kjo agjendë ka qenë edhe në webfaqen e komunës. Mbarëvajtja e procesit 30 ditorë; manifestimi ka filluar me datë 15 korrik-15 gusht, konsiderojmë që ishte një organizim dhe aktivitet më i madh deri më tanë. Me qëllim të ofrimit të mundësisë për takime reciproke ndërmjet mërgimtarëve tanë dhe autoriteteve lokale. Komuna e Rahovecit gjegjësisht DKRS ka organizuar

aktivitetë të shumta duke filluar nga turneu në futboll, shah, koncerete të ndryshme, sofrën e mërgimtarëve. Kryetari i komunës për një muaj rresht ka pasur takime të rregullta me mërgimtarë duke filluar nga ora 10:00 çdo ditë duke shpalosur mundësitë dhe thirrjet rrreth investimeve në komunën tonë e kshtu me radhë. Kemi patur grupe të ndryshme të muzikës; Fisnikët, 04 band Xheriko dhe artistë tjerë të ndryshëm nga komuna jonë. Përveç koncerteve janë mbajtur edhe sofrat e mërgimtarit që janë pritur shumë mirë, në Drenoc, Krushë e Madhe dhe Ratkoc. Gjithashtu në kuadër të këtyre manifestimeve janë bërë edhe dy promovime të librave; "Deri në fryshtë e fundit" për dëshmorin Skender Gashi me autor Qemajl Krasniqi. Libri "100 kultivarë" nga Rexhep Kryeziu. Eshtë organizuar turneu dy ditorë ndërkombëtar në shah "Korriku 98" ku kanë marrur pjesë 106 garues nga Shqipëria, Finlanda, Kosova, Austria, Mali i zi dhe Maqedonia e veriut. Më posht në material i keni të gjitha aktivitetet tona me anë të fotove, ku për secilin aktivitet kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve. Gjatë muajit të mërgatës me datë 21 korrik ka qenë edhe përkujtimi i dëshmorëve te maja e Shkodranit, ku në të njëjtën ditë është bërë përrurimi i hapësirës rekreative për të rinjët. Për fund, e falënderoj policinë e Kosovës të cilët për një muaj rresht n'a kanë përcjellur që çdo aktivitet të ketë mbarëvajtje ashtu siç duhet, gjithashtu falënderoj edhe bizneset në rrugën "Xhevati Kasapi" të cilët kanë qenë të gatshëm dhe kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Ndonjë koment për këtë pikë të rendit të ditës?... Atëherë po vazhdojmë me pikën e tretë;

3. Shqyrtimi i planit komunale për menaxhimin e mbeturinave 2022-2026;

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e KPF-së, të gjithë ju prezent. Në diskutim publik ka përfundur plani i menaxhimit të mbeturinave prej datës 11.08-11.09 sipas ligjit për qeverisje lokale, poashtu është mbajtur edhe një diskutim publik në sallën e kuvendit me datë 25.08.2022. Plani i menaxhimit ka afat pesë vjeçar në këtë rast komuna e Rahovecit ka zotim dhe obligim ligjor mjedisin ekologjik në komunë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit të qytetarëve. Ky plan i ka të gjitha specifikat që i kërkon ligji, duke përfshirë operimin, strategjinë dhe volumshnérinë të menaxhimit të mbeturinave, ndarjen, inkasimin, koston e shërbimit, siç e dini sipas ligjit, komuna e Rahovecit është e obliguar që të caktoj edhe tarifat për mbledhjen e tyre mbeturinave. Në përfundim të këtij plani janë paraparë objektivat dhe vizioni i këtij plani për periudhën 2022-2027.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Dikush diçka lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e këtij plani?... Me shumicë votash miratohet edhe pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i propozim vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2023;

Afrim Limani – Përshëndetje kryesues, përshëndetje anëtarë të KPF-së. Pak me vonesë por me datë 16.08.2022 ka arritur qarkurja e dytë buxhetore ku edhe janë përcaktuar limitet dhe tavanet buxhetore dhe pjesa apo "hisja" e buxhetit të komunës së Rahovecit për vitin 2023 si dhe projekzionet 2023-2025. Nuk ka ndonjë dallim të madh nga qarkorja buxhetore por vetëm kemi një zbritje prej 50.000euro nga pozicionet, nga kategoria e investimeve kapitale janë rritur pagat prej 50.000euro. Ndryshim tjetër për të mirë është një shtim të stafit në qerdhe d.mth. për arsim rrëth 21 vende dhe është zgjedhur stafi në shëndetësi, nga 69 në 52. Pra ky është dallim në mes të qarkores së parë dhe të dytë. Andaj buxheti për komunën e Rahovecit për vitin 2023 në total është prej 17.548.240. Të hyrat vetanake 1.445.000, granti është 16.102.000 ku përfshihet granti për shëndetësi prej 2.600.000 dhe grantin e arsimit prej 5.872.000. Pra, dallimi nga viti 2022 në vitin 2023 kemi një rritje të buxhetit në vlerë prej 2.494.000euro më pas buxhetin e kemi shpërndarë në projeksione në të gjitha kategoritë ekonomike që e keni materialin. Kalojmë te lista e investimeve kapitale, është e njëjta listë me atë që ju e keni, mirëpo këtu siç po shihet jemi korrekt dhe transparent me ju duke e parë përbajtjen në tabelë, pjesa që janë të hijezuara me ngjyrë të verdhë, janë projekte kapitale të cilat janë nga viti i kaluar mirëpo departamenti i buxhetit i ka klasifikuar si keqklasifikime, prandaj këto nuk janë në listën e projekteve kapitele që i keni ju. Këto janë

futur në kategorinë mallra dhe shërbime të cilat janë rritur për vitin 2023 dhe janë rreth 400.000 euro. Në këtë tabelar është i prezantuar edhe buxheti i vitit 2022 si pasqyrë ose si masë krahasuese që ju ta keni si informatë dhe t'i shihni ndryshimet që janë bërë në projekte kapitale. Në fund e kemi listën për projekcionet e vitit 2023. Në kuadër të projekteve kapitale janë të futura të gjitha kërkesat e qytetarëve, që kanë dalur si rezultat i dëgjimeve buxhetore edhe pse juve ndoshta nuk iu doket që po, por për shkak të sistemit P.I.P (Programi i investimeve publike) i cili nuk e lejon hapësirën t'i fusim të gjitha të dhënat, atëherë çdo kërkesë është në kuadër të këtyre projekteve. Për here të pare jemi shumë komod që vitin e ardhshëm krijojmë një stabilitet financiar. Ju e keni një listë të obligimeve kontraktuale e cila është 2.5 milion dhe nëse këtyre obligimeve iu shtojmë edhe disa projekte që janë në proces. Diçka tjetër nuk di, po e lë më tepër për kuvend dhe pres ndonjë pyetje.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Atëherë po e filloj unë i pari një pyetje; Forma e dëgjimeve buxhetore që organizohen prej ekzekutivit po edhe që është obligim ligjor edhe prej kuvendit komunal, rrjedhimisht prej KPF-së, ju po thoni që i keni vendosur kërkesat e qytetarëve prej çdo lokaliteti, këtu nuk janë të specifikuara. P.sh. Nëse një kërkesë ka ardhur prej fshatit Malësi e Vogël për ndriçim publik, ndërsa këtu po thuhet që ndriçimi publik është për të gjithë komunën e Rahovecit, si është e garantuar që ky investim do t'a kap Malësinë e Vogël, duke marrë parasysh kërkesën që ka ardhur nga banorët atje?... Pyetja tjetër; Te investimet kapitale nëse është mundësia të na tregosh se cilat janë ato projekte që janë të përfunduara, ndërsa borgji nuk është kryer?...

Burim Krasniqi - Faleminderit kryesues, ekzekutiv, kolegë, të gjithë që jeni këtu. Atë që LDK – dega në Rahovec, ka arritur t'a shqyrtojë, trajtojë, bashkbisedoj janë disa prej temave që janë përsëritur në vazhdimësi prej LDK-së edhe në përbërjen e kaluar të asamblesë komunale. Ne vlerësojmë që buxheti i komunës për vitin 2023 si dhe projekcionet buxhetore 2024-2025 duhet të përcjellen së paku me një narrativ të përshkrimit të qëllimeve që ky buxhet duhet t'i arrijë ky buxhet me këto projeksione, duke përfshirë të gjitha fushat në komunën e Rahovecit; rregullimin e trotuareve, rrugëve, ndriçimit, sa kemi bërë deri tani, sa kemi synim të arrijmë dhe ku kemi synim të arrijmë me këtë buxhet që është vetëm shifra që parimisht janë pare që duhet të paguhen po realisht nuk është synimi i kuartë që komuna e ka me buxhetin. Ekziston mundësia shumë e thjesht që të specifikohen punimet saktë se ku do të bëhen, cila rrugë do të shtrohet me kubëza, cilës rrugë do t'i bëhet ndriçimi publik, cilës rrugë do t'i shtrohet trotuari, ujë, kanalizim etj... LDK dhe unë si përfaqësues i LDK-së në KPF, kërkojmë që kur të vie buxheti në kuvend komunal, rrugët të janë të specifikuara, sepse goxha është e përgjithshme, nuk qëndron ajo që nuk e lejon sistemi, nuk e kufizon numrin e kodeve, por një kod mund të ketë nënkode. Kërsesat e qytetarëve nuk besoj që janë përfshirë sepse në buxhet nuk po e shoh askund aneksin e shtëpisë së kulturës në Krushë të Madhe që ka të bëjë me pjesën e zhveshtores të shoqërisë kulturo-artistike "Bajram Curri" të cilën komuna e Rahovecit e ka rrënuar. Askund nuk po e shoh si kod buxhetor, ndoshta është e përfshirë por është e përgjithësuar gjithçka. Nuk ka diçka rreth kolektorit kryesor Hoçë e Madhe - Krushë e Madhe dhe për përraska që përfshihet prej Hoçës së Madhe deri në Krushë të madhe, së paku të parashihet në buxhet në çoftëse është investim i ministrisë duhet ekzistoj një momerandum për të bërë investime në komunën e Rahovecit. Drejtor, te lista e investimeve kapitale një prej shembujve që ka gabim të thjeshtë është vendosja e ashensorit në objektin e ndërtesës së komunës, e keni të paraparë 5.000 në 2022 vitet tjera nuk po shoh asgjë, e në fund totali është 15.000 euro që i bie 10.000 nuk janë askund të parapara. (kodi buxhetor 49841). Faleminderit shumë për listën e obligimeve që n'a ke dërguar në bazë të kërkesës tonë, por afati i mbetjes së kontratës nuk është real, në çoftëse një kontratë është e lidhur në 2019 që ka një periudhë kohore 36 muaj, nuk mund t'i ketë edhe 11 muaj afat, sepse ky vit kalendarik nuk i ka edhe 11

muaj të mbeturë. Trajtimi i kanalizimeve fekale – gropave septike në komunën e Rahovecit, është lidhur në 2019 me 36 muaj dhe thuhet edhe 11 muaj i ka afat për ekzekutimin e kontratës, mund t'i ketë edhe 3 muaj maksimalisht në çoftëse bëhet deri me 31.12.2022. Shkolla filllore e mesme e ulët "Liria" në Fortesë është kontrata në 2019, obligime janë edhe 217.000euro dhe thuhet që edhe 12 muaj janë afat për realizimin e kontratës. Nuk është e mundur kjo, të gjitha kontratat që janë të lidhura në 2019 ose janë të skaduara ose i kanë edhe 3 muaj afat. Po i bashkohem kërkesës së kryesuesit që të specifikohen kuartë gjërat dhe të kemi një konsensus që LDK të ketë një votë pro buxhetit të komunës së Rahovecit. LDK të ketë votën pro duhet të plotësohen kërkesat e cekura më herët, buxheti të ketë një përshkrim se ku synojmë të arrijmë me këtë buxhet, të jemi në dijeni edhe sa fshatra mbeten pa ujë, pa kanalizim, pa rrugë d.m.th të përshkruhet komplet, të jetë buxheti narrativ e jo vetëm shifra. E dyta; të specifikohen vendet se ku do të ketë investime, ose ku është investuar e që kemi ende obligim. Merimetimi i shkollave, cilës shkollë?... Merimetimi i objekteve komunale, cilit objekt komunal?... Jam i bindur që komuna e Rahovecit ka staf të mjaftueshmë profesional që gjatë tërë vitit të marrin kërkesat dhe nevojat, t'i kenë të listuara kur të vijmë në këtë fazë. E treta; që kërkojmë si LDK është që jemi në dijeni se cilat janë objektet të kryera që janë jo obligime kontraktuale por janë obligime financiare dhe cilat janë kontratat me obligime kontraktuale. Aneksi në Krushë të Madhe dhe çështja e përrockës dhe kolektorit në Hoçë e Madhe – Krushë e Vogël që bie nëpër Brestoc – Hoçë – Nagac – Krushë. Faleminderit shumë.

Afrim Limani – Kryesues, pyetjen e parë nuk e ndëgjova, mendova që po iu drejtoshesh kolegëve tjerë. Pyetja e dytë që edhe të njëjtën pyetje e bëri edhe Burimi për përbajtjen e projekteve. P.sh ndërtimi i rrugëve, ku do të ndërtohen?... kalanizimet? E shumë projekte tjera...

Në fillim thash, për shkak të sistemit P.I.P, sistem ky që është një softwer që i bartim të dhënat, i cili nuk na lejon të zgjerohemi edhe të bëjmë përshkrime të lokacioneve, secili drejtor në kuadër të drejtoreve të veta e ka planin e investimeve, nëse dëshironi përmbladhje të kuvendit ne iu japim të gatshme se ku do të kryhen këto investime të parapara sepse çdo gjë është e definuar dhe arsyaja e vetme që nuk e kemi bërë përshkrimin është kjo. Tjetër, nga viti i kaluar për shkak të udhëzimit 04-2019 është shumë problem që një projekt i ri të futet në sistemin P.I.P. Vitin e kaluar rrëth 6 projekta n'a kanë eleminuar dhe janë shumë kritere të ndryshme dhe është problem i madh dhe atëherë kemi vepruar që në kuadër të projekteve ekzistuese, në kuadër të kodit ekonomit dhe i kemi ndarë në lloto, njejtë c kemi edhe projektin për kanalin në Krushë, projekt ekziston, ka një numër të kodit ekonomik, është në kuadër të drejtorisë së urbanizmit. Në kuadër të këtij projekt komuna e Rahovecit e buxheton vetëm një lloto ndërsa në dy lloto të tjera e kemi marrëveshjen që e financon ministria e planifikimit. Te obligimet kontraktuale, janë kontraktuale dhe jo financiare, janë kryer punimet është myllur kontrata dhe që nuk kemi arritur t'a paguajmë dhe e kemi faturën në pritje është obligim financiar, por nëse operatori nuk e ka dorëzuar faturën, atëherë për neve është obligim kontraktual. Kjo është rregull financiare. P.sh; Shkolla në Fortesë, afati kohor i kontratës ka skaduar – aty kemi obligim financiar sepse fatura është dorëzuar.

Burim Krasniqi – Kur the që janë përfshi të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe buxheti është i kuartë, atëherë ne dëshirojmë t'i shohim kërkesat që janë përfshirë në buxhet. Si LDK kërkoj që kur të vie buxheti në kuvend, të jetë bashkë me shtesën - me përshkrim specifik për secilin projekt dhe të miratohet komplet. E dyta; Te sheshi qëndror në Rahovec i keni paraparë 4.5million euro. Para 3 viteve që është bërë projekt, projeksionet e të cilët e kanë paraparë që sheshi të kushtojë rrëth 7.5 milion nëse nuk jam gabim, kështu thuhet edhe nëpër opinion. Nëse ka qenë para 3 viteve 7 milion, sot kushton së paku 10 për shkak të rritjes së çmimeve. A mund t'a mbulojë financierisht ky 7.5 milionshi, apo planifikoni t'ia filloni deri kur të vie buxheti i vitit 2024 t'a shqyrtoni dhe rritni buxhetin për dy vitet tjera që mbesin.

Afrim Limani – Te sheshi; Burim, unë nuk e di se çka keni folë më herët, 7 ose 5 por, një gjë e di sigurtë me letra, vlera e ktij projekti ka qenë e parashikuar 5.1 milion. Kur e kemi buxhetuar buxhetin e kemi menduar që përafërsisht ai që e fiton kontratën do të jetë 4.4 milion. Para 3 dite e kam informacion nga zyra e prokurimit që është bërë hapja e ofertave dhe vlera më e ulët është 3.8 milion, unë e kam bërë planifikimin për 4.4 milion që realisht i bie 700.000 euro taprojnë në planifikim. Të gjitha projektet për shkak të gjendjes së mirë financiare në vitin 2023 janë të buxhetuara saktësisht 98%, këtë e argumentoj me faktin sepse lista e obligimeve kontraktuale është 8.5 milion, nëse ia sheshin rrëth 4 milion, nëse ia shtojmë edhe ndërtimin e shkollave rrëth 2.5, qendra rimore rrëth 2 milion, totali i bie 17 milion kurse ne projekcionet buxhetore i kemi 20 milion si dhe 1.7 milion i kemi buxhet që akome nuk është shpenzuar dhe jemi shumë komod në këtë drejtim.

Burim Krasniqi – Drejtor, d.m.th sheshi llogaritet vitin tjetër të filloj, këtë vit lidhet kontrata mund të punohet pak shkaku i kushteve atmosferike. E kam një pyetje pak më ndryshe; Kf. Rahoveci është fatbardhësish pretendent për superligë, me fitore të vazhdueshme – drejtori çdo lojë po e poston në facebook dhe po mburret me rezultate. Ku do të luan Rahoveci vitin tjetër futboll dhe a ka buxhet të paraparë për stadiumin e qytetit, sepse nëse fillon sheshi para se të bëhet stadiumi nënkuption që klubit do të luaj ose në Suharekë ose deri sa kalon në superligë mund të luaj edhe në Xérxe por nëse kalon në superligë mund të luaj në Suharekë, Gjakovë, Malishevë, kjo nënkuption që mund të ketë efekt negativ në entuziazëm dhe në rezultate të klubit.

Afrim Limani – Ajo çka mund të them sigurtë është që stadiumin e kemi buxhetuar për vitin e ardhshëm përafërsisht mbyllt ajo kontratë, ku do të luajnë vitin e ardhshëm, nuk jam përgjegjës në këtë çështje por mendoj që ka shumë punë deri sa të vijmë te stadiumi.

Bejtullah Deliu – Përvendetje kryesues, zv.kryetar, drejtor, kolegë. Deshta të ndërlidhem; si vazhdimësi e pyetjes së kryesuesit dhe kolegut Burim lidhur me specifikimin e projekteve, ju thatë që vet projekti apo titulli i projektit tregon se ku po investohet. Ky mosspecifikim lejon edhe manovrim të lokacioneve ndoshta diku është jetik ndonjë kanalizim, ndërkohë mund të kryhet ndonjë punë dytësore-tretësore e qytetarët të janë në pritje për nevoja bazike. Për këtë arsy është më e duhur dhe korrekte që në këto projekte të ceket shuma dhe vendi se ku do të kryhen punët. P.sh. në Drenoc kemi probleme bukur të mëdha edhe me kanalizim, ujë, rrymë. Mendoj që kahja e investimeve duhet të dihet saktësisht.

Afrim Limani – Bejtë, faleminderit për pyetjen. Dua t'a jap edhe një informatë; para se të lidhjet një kontratë, bëhet hartimi i projektit – sa mund të jetë kostoja, caktohen paramasat dhe elementet e tjera. Drejtori i shërbimeve publike i ka akumuluar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe mbi bazën e këtyre kërkesave e ka bërë hartimin e projektit, përafërsisht dihet kostoja, projekti shpallet dhe dikush e fiton. Në mbledhjen e kuvendit do t'a keni materialin e ndërtimit të rrugëve, kanalizimeve dhe të tjera, do të dihet saktë se ku do të investohet.

Afrim Dina – Faleminderit, Burimi e bëri një pyetje sa i përket aneksit të shpisë së kulturës. Aneksi është i përfshirë, kemi filluar pak më herët atje demolimet, kemi kontratë aty. Para fillimit të themelit është dashur t'a bëjmë pak revidimin e objektit sepse salla ka qenë pak e ngushtë, kjo n'a merrë më shumë kohë për nisje të ndërtimit. Kodi 45349 riparimi i monumenteve historike kjo është kontratë për aneksin e Krushës së Madhe, kontrata është 96.000 euro. Pyetja tjetër rrëth klubit të futbollit, unë pak mundohem t'i motivoj sepse ne e kemi vendin në superligë. Janë në rrugë të mirë. Me 9 prill është lidhur memorandumi mes komunës dhe ministrisë për rregullimin e stadiumit në Rahovec, palestrës sportive në Krushe dhe në Ratkoc. Mirëpo ky memorandum prej qeverisë nuk është zbatuar. Ne jemi duke i zbatuar punimet te kompleksi sportiv atje nalt, i kemi edhe mjetet dhe besoj që do të arrijmë që në kompleksin sportiv të jeni të gjitha kushtet me standarde që të zhvillohen ndeshjet e futbollit.

Burim Krasniqi – Te kodi drejtor, për 2022 janë paraparë 40.000euro, 20.000 grant, 20.000 të hyra vetanake, te reparimi i monumenteve historike aty nuk ka filluar asgjë të ndërtohet. E di që ka një pakënaqësi për shkak të dimensioneve të hapësirës për nevojat e shoqërisë kulturo-artistike. Në çoftëse nuk është bërë asgjë sivjet, për vitin tjetër arrijnë të barten vetëm të hyrat vetanake 20.000euro sepse granti shfrytëzohet ose shkon në suficit, si dhe për vitin tjetër janë të parapara 20.000euro tjera, a janë të mjaftueshme 40.000euro për ndërtimin e këtij aneksi dhe t'i plotësoj të gjitha kërkësat e shoqërisë kulturo-artistike “Bajram Curri”....

Kryesuesi – Faleminderit shumë të gjithë diskutuesve, nëse nuk ka dikush diçka shtesë?...Atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?...Me shumicë votash aprovohet kjo pikë.

5. Shqyrimi i programit komunal tre vjeçar për banim 2022-2024;

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, drejtorë, drejtoresha, kuvendarë. Më lejoni që sot para jush në emër të planifikimit konkret për ndihmë për banin social dhe draftimin e dokumentit tre vjeçare. Ky plan i banimit konkretisht orientohet në dy objektiva kryesore e që ka të bëjë konkretisht me funksionalizimin e data bazës për banimin social dhe të njëjtën kohë për sigurimin e banimit për 88 familje në kuadër të këtij dokumenti. Fuksionalizimi i databazës për banim social ka filluar të hyjë në proces nga ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor. Komuna menjëherë ka përcaktuar zyrtarin përkatës për banim social, jemi në pritje të funksionalizimit të banimit social, poashtu e kemi edhe regjistrin e saktë të numrit të familjeve që kanë nevojë për banim. Banimi social në brendësi ka 18 njësi banesore dhe funksionalizimi i saj pritet të përfundoj gjatë këtij viti me një kosto rrëth 50.000euro, më tutje vazhdojmë me përkrahje individuale për ndërtimin e shtëpive për 20 familje, pagesa e bonus banimit për 20 familje dhe riparimet eventuale për familjet në nevojë. Shuma totale ka koston e rrëth 623.000euro, komuna e Rahovecit, donatorët dhe ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor. Në emër të grupit punues të draftimit falënderoj organizatën “Voice of Rome, Ashkalinj, Egjiptianë”si organizat në bashkëpunim duke na ndihmuar me ekspertizën e saj. Uroj që ky dokument të shkoj në mënyrën më të mirë të mundshme dhe sot t'i kaloj ti gjitha procedurat e votimit.

Besmire Bytyqi – Faleminderit kryesues, gjithashtu falënderoj edhe Lendritin për sjelljen e këtyre informacioneve, e kam vetëm një pyetje për Lendritin, te tabela nr.10, pika 11 ku thuhet; Kërkesa aktuale për banim social në njëren kategori është “Nënët e vetmuara”, konsideroj që duhet të jetë “Nënët vetushqyese” sepse ekziston dallim i madh ndërmjet këtyre dy termave, kërkoj rishqyrtim dhe me mundësi t'a ndryshoni.

Lendrit Qeli – Kjo duhet të ndryshohet, ka ardhur direkt prej ministrisë, e kemi inkorporuar direkt ashtu siç ka qenë. Besoj kemi mundësi editimi dhe t'a vendosim termin e duhur.

Burim Krasniqi – Objekti i banimit kolektiv a është afér finalizimit, besoj që finalizimi i objektit kolektiv i ik pagesës së qirasë për familjet që kanë nevojë për banim dhe ndërlidhet që redukton koston e shpenzimeve të komunës në raport me pagesat e banimeve sociale. E dyta, është paraparë një buxhet për riparimin e dëmeve që mund të shkaktojnë familjet nëpër shpija private që merren me qera nga ata që kanë nevojë, a është caktuar ndonjë kriter? Të ketë një masë se çka paguan komuna, besoj që duhet të ketë një kufi të caktuar. Te tabela 3, te popullsia, a janë të sakta këto shënimë sepse te unë nuk po përputhen. Vetëm 404 Ashkali, 299 Egjiptianë, 84 Romë d.m.th a janë këto statistike të sakta apo jo, më duket joserioze kur lexohet.

Lendrit Qeli – Faleminderit për pyetjen. Sa i përket pyetjes së parë, në informatatë që i kemi prej drejtorisë përkatëse thuhet që vlera e këtij objekti ka një vlerë prej 50.000euro sepse janë 18 njësi banesore, pjesën tjetër do të duhen fondet prej bashkëpunimeve tjera sepse synimi ynë është numri i 88 familjeve. Pyetja lidhur me informatat e komuniteteve joshumicë; këto informata janë të sakta për komunitetit Romë, Ashkalinj, Egjiptianë, ndërsa sa i përket komunitetit Serbë është dashur t'i referohemi regjistrimint të fundit civil zyrtarisht. E treta; këto njësi banesore nuk do të dhurohet falas, do të janë në shfrytëzim. Më vonë mund të ndryshoj situata që ata të gjijnë një banim të përhershëm dhe të zëvendësohen me dikë tjetër që ka nevojë. Do të ketë një pagesë modeste me qëllim të mirëmbajtjes së ambientit aty.

Kryesuesi – Faleminderit Lendrit, dikush tjetër ndonjë pyetje?... Atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe plani komunal tre vjeçar për banim 2022-2024.

6. Shqyrtimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës P- 71510033-01041-1 zona kadastrale Xërxe;

Afrim Orqi – Faleminderi kryesues. I nderuar nënkyetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni propozimin sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovës propozimin e kryetarit të komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelës me nr. 1041-1 në zonën kadastrale në Xërxe, bëhet fjalë për parcelën me emër të pronarit Isni Vehbi Thaqi me sipërsaqe 14 e 72m katror. Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm është hapja e rrugës publike. Parcata në fjalë sipas PZHK-së ka destinim si tokë ndërtimore. Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronë do të kujdeset për proceset tjera, ftoj anëtarët e KPF-së që të votojnë për propozim vendimin për interes të përgjithshëm të parcelës në fjalë.

Burim Krasniqi – Meqenëse jemi në proces të shpalljes me interes të përgjithshëm dhe ka të bëjë për të njëjtën hapësirë është objekti ish matreks. A ekziston që ne ta marrim një vendim dhe të gjitha këtë copëza të parcelave të janë në një parcelë, të bashkohet të gjitha në një parcelë, sepse ka shumë numra dhe është i njëjtë send.

Afrim Oruqi – Parcelat publike në atë zonë te depot e matreksit janë prona të komunës dhe secila ka sipërsaqen dhe numrin e vet, për t'a bashkuar një parcelë ose ndarë sipas ligjit duhet të bëjmë kërkësë prej kryetarit të komunës nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar sipas ligjit. Përndryshe këtu kemi kërkuar pëlqim për një parcelë që është private, ku parcelat e komunës janë në kufi dhe nëpërmjet kësaj parcele private kalohet dhe bëhet rruga për të depërtuar në depo dhe në pjesë tjera. Nuk është problem t'i bashkojmë këto por është një procedurë ligure. Kërkesa për bashkim nuk na ndihmon asgjë të shkojmë drejtë këtij realizimi.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, nëse nuk ka më pyetje, po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Para jush keni propozimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtë deri në 5 vite për pronat e paluajtshme të komunës. Bëhet fjalë për lokalet e palestrës. Bazuar te vendimi paraprak të kuvendit të datës 30.11.2020 të vendimit 136/20, këto lokale kanë qenë në ankand më herët, por nuk ka patur interesim për marrje në shfrytëzim dhe në bazë të këtij vendimi kërkojmë formimin e këtij komisioni i cili përbëhet prej 5 anëtarëve 2 nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritarë, ftoj anëtarët e KPF-së për votim.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Ndonjë pyetje... Atëherë po e vendosim në votim, kush është për?...


Aaprovohet me shumicë votash edhe pika e shtatë dhe kalon në seancën e rregullt të kuvendit.

8. Të ndryshme;

Kryesuesi - Ndonjë çështje shtesë, ndonjë diskutim? Nëse jo, atëherë këtu po e përmbyllim mbledhjen e tetë të KPF-së. Shihemi në seancën e rregullt.

Mbledhja përfundoj në 11:30

Procesimbajtësi;


Agim Hoti

